

URDHËR
Nr. 139, datë 29.7.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Emis Çerava, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për çështjet e mëposhtme:

1.1 Delegim i kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për kryerjen e të gjitha procedurave të prokurimit publik për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

1.2 Nënshkrimin e autorizimeve për dërgimin me shërbim të punonjësve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jashtë qendrës së punës, brenda vendit në largësi mbi 100 km, si dhe ato për jashtë territorit të Shqipërisë.

1.3 Nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësim ligjor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emër të personit që do të përfaqësojë Këshillin e Lartë të Prokurorisë në procese gjyqësore.

1.4 Përfaqësimi ligjor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në proceset gjyqësore, sipas pikës 1.3 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

2. Delegimi i kompetencave përfundon në datën 1.8.2022.

3. Ngarkohet z. Emis Çerava, Sekretar i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi